REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 06/08/2026

PROCES – VERBAL
"I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 06.08.2026"

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

Janë prezent në mbledhje 13 këshilltarë:

1. Kujtim Dervishi
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Nexhip Elezi
5. Naime Ibrahimi
6. Gezim Gjoshi
7. Aleksander Idrizi
8. Libeta Kotorri
9. Nertila Uruçi
10. Enkeleda Kullolli
11. Bujar Blloku
12. Avni Shtylla
13. Sami Uruçi

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak.Në mbledhje merr pjesë Kryetari I Bashkisë Arif Tafani.
- Kryetari lexon rendin e ditës për këshilltarët prezentë.
- Kujtim Dervishi: Propozon që të futet në rend dite shkresa për njohjen me propozimin për reformën territoriale. Lexon draftin (shkresën) propozuese për reformën territoriale.
- Kryetari i këshillit lexon një deklaratë personale në lidhje me reformën administrative.
- K. Dervishi: Mendoj që duhen patjetër konsultime publike me qytetarët dhe në përfundim të marrim një vendim në përputhje me zërin e qytetarëve.
- Arif Tafani: Jam në një mendim me Kryetarin e Këshillit, duhen bërë konsultime publike.
- Arif Tafani: Të zhvillojmë kosultime në të 5 njësitë administrative,ku të marrin pjesë qytetarët dhe të gjithë këshilltarët.Duhet lexuar ligji që të dalin argumenta,korigjime dhe sugjerime kundrejt komisionit.
- Nertila Uruçi: Mendoj që duhet të shprehim ne mendimin personal. Projekt Ligji thotë që do kemi një n/kryetar dhe nuk jam dakord spese do jetë i ëmëruar.

- Kujtim D: Propozoj që javën e parë të shtatorit të lihen konsultimet publike.Kalojmë te pika nr.1 e rendit të ditës , "Ndihma Ekonomike".Mbron p/vendimin E.Dervishi.
- Hidhet në votim 6% dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës: P/Vendim mbi ndryshimin e planifikimit të të ardhurave për vitin 2026.
- Mbron Ditjon Pepa:Këmi kaluar planin nga lejet e ndërtimit që ka lëshuar Bashkia.
- N.Uruçi: Keni bërë një analizë si do të ndahen?
- D.Pepa: Kemi një pikë tjetër ku do diskutohet.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro pika nr.2.
- Kalojmë te pika nr.3 e rendit të ditës për një ndryshim në buxhetin 2026. Mbron Ditjon Pepa.
- N.Uruçi: Duhet bërë një verifikim për hedhjen e mbeturinave në fshatin Trojas.
- A.Tafani: Shuma shkon për Green Belsh spese ka rritje pagash sipas vendimit të qeverisë dhe një pjesë buxheti shkon për kalimin për menaxhim të Zip Line me shtesë 2 punonjës të rinj.
- Hidhet në votim dhe kalon me 11 vota pro dhe 2 vota abstenim.
- Kalojmë te pika nr.4 e rendit të ditës: P/Vendim për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin 2026.
- Hidhet në votim dhe kalon me 13 vota pro pika nr.4 e rendit të ditës/
- Kalojmë te pika nr.5 e rendit të ditës: "P/Vendim për miratimin e tavaneve të shpenzimeve për projekt buxhetin afatmesëm 2027-2029",Faza e II-të.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro dhe 2 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës:"P/Vendim për dhënien në menaxhim të ZIP LINE shoqërisë Green Belsh Sh.a.
- N.Uruçi: Nëse përfitimet nuk mbulojnë punonjësit si do procedohet?
- Arif Tafani: Ardhja e turistëve sjell ekonomi në Belsh. Nuk është qëllim fitimi por sjellja e turistëve dhe bërja e Belshit sa më të njohur.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro dhe 1 abstenim pika nr.6 e rendit të ditës.

- **Mbyllet mbledhja me 6 vendime të miratuara.**

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA

